



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**NJOFTIM PËR MEDIA**

Ditën e mërkurë, në datën 19 maj 2021, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e AMA-s, nr. 38, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonale që përfshihen në skemën e kompensimit financiar sipas ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e frekuencave të Dixhital-Dividentit” të ndryshuar”. **(Vendimi nr. 69, datë 19.05.2021)**
2. Miratimin e lehtësimit financiar për subjektet audio dhe audiovizivë. **(Vendimi nr. 70, datë 19.05.2021)**
3. Rrëzimin e aplikimit të subjektit person fizik Guri Meko, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Aral”, për zgjerimin e zonës së shërbimit në njësinë administrative Çërravë”. **(Vendimi nr. 71, datë 19.05.2021)**
4. Kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca e subjektit person fizik Alban Shehu, për shërbimit e programit audioviziv “Tv Berati”, tek shoqëria “TV BERATI” sh.p.k. **(Vendimi nr. 72, datë 19.05.2021)**

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 19.05.2021**